

Në bazë të nenit 10 paragrafi (1) dhe paragrafi (6) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 19-të mbajtur më 25.04.2024, në lidhje me Propozimin nr.03-2057/1 datë 25.04.2024 për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër SHTR „KLAN MAQEDONI“ SHPKNJP eksport-import – Saraj, Shkup për shkelje të nenit 76-b të Kodit Zgjedhor, miratoi si vijon:

KONKLUZION

1. Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer (monitorim) mbi përfaqësimin mediatik zgjedhor nr.10-2054/1 datë 25.04.2024 të SHTR „KLAN MAQEDONI“ SHPKNJP eksport-import – Saraj, Shkup përcaktoi shkelje të nenit 76-b paragrafi (3), dhe në lidhje me nenin 69-a paragrafi (2) të Kodit Zgjedhor.

2. Këshilli konkludoi kundër SHTR „KLAN MAQEDONI“ SHPKNJP EKSPORT-IMPORT – SARAJ, SHKUP të inicojë procedure për kundërvajtje para gjykatës kompetente, pasi nga mbikëqyrja u konstatua se në kundërshtim me nenin 76-b paragrafi (3) dhe në lidhje me nenin 69-a paragrafi (2) të Kodit Zgjedhor, më datë 23 dhe 24 prill 2024 gjatë kohës së informimit të heshtjes zgjedhore për rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale 2024, në shumë programe/përmbajtje ka transmetuar informacion dhe materiale audiovizuale lidhur me pjesëmarrës ose përfaqësues në zgjedhje.

3. Detyrohet Sektori për çështje juridike të përgatisë Kërkesën për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

4. Kopje e Konkluzionin duhet t'i dorëzohet:

- Udhëheqësve të të gjithë sektorëve të Agjencisë;
- Personit të emëruar nga Agjencia, për udhëheqjen e lëndëve sipas procedurës administrative;
- Njesisë për mbështetjen e punës së Këshillit të Agjencisë;
- Sektorit për mbështetje informatike dhe i punëve të përgjithëshme – Arkivi i Agjencisë.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.